

Të shtëna me armë zjarri në Bregun e Diellit, katër persona shoqërohen në stacion



14/05/2023 20:58

f


t

e

Të shtëna me armë zjarri ka pasur sot rreth orës 18:30 në rrugën Gazmend Zajmi, në Prishtinë. Kjo është konfirmuar nga Flora Ahmeti- zëdhënëse në Policinë e Kosovës për rajonin e Prishtinës.

“Rreth orës 18:30, policia ka marrë informatën për të shtëna me armë në rrugën “Gazmend Zajmi” në Prishtinë. Menjëherë pas marrjes së informatës policia ka dalë në vendin e ngjarjes dhe ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që konsistojnë në hetimin e rrethanave që karakterizojnë ngjarjen. Bazuar në informacionet fillestare nuk raportohet për persona të lënduar” ka thënë Ahmeti.

Po ashtu Ahmeti ka bërë të ditur se lidhur me këtë rast zyrtarët policor të stacioneve veriu dhe qendra kanë arrit që në lagjen Arbëria, të ndalojnë një automjet të dyshuar dhe të gjejnë dhe sekuestrojnë një armë AK-47, të cilën njëri nga të dyshuarit e ka hedhë në mbeturina.



Arma e sekuestruar

Deri tani në stacion policor janë shoqëruar në stacion katër persona të cilët dyshohet se kanë qenë të përfshirë.

Aktualisht hetuesit policor në koordinim me prokurorin e shtetit po ndërmarrin veprimet e nevojshme për zbardhjen e rastit./Lajmi.net/


Artikuj të ngjashëm



May 15, 2023
Prishtinasi shkrep në drejtim të tre personave, kallashin më pas e...



May 15, 2023
Petkoviç u takua me Lajçak përpara raundit të ri të dialogut me Prishtinën



May 15, 2023
Zgjedhjet në Shqipëri: Përfundon numërimi në 17 bashki, PS merr 13...



May 15, 2023
Kurti takon kryetarët e komunave, zbardhen temat që pritet t'i diskutojë...



May 15, 2023
Ukraina në luftë, Macron i premton më shumë përkrahje Zelenskyt



May 15, 2023
A po “dorëzohet” Erdogan? Pranon mundësinë që të shkojë në balotazh...

LAJME TË FUNDIT

E arta olimpike, Distria e para në botë

Prishtinasi shkrep në drejtim të tre personave, kallashin...

Petkoviç u takua me Lajçak përpara raundit të ri të dialogut me Prishtinën

Të gjithë e duan rikthimin e Messit, Laporta:...